



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program E drejta penale (2017/2018)

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër i shkencave juridike - Drejtimi: E drejta penale
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-612/10
Vendimi për fillim me punë	03-1619/18 (10.11.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

Përshkrimi i programit

Programi studimor e drejta penale synon të ofrojë një gamë të moduleve që do të përbëjnë bazën e informacioneve dhe të dijeve të avancuara mbi lëndët juridike penale me qëllim të aftësisht profesional të studentëve për profesionet themelore juridike që lidhen me këtë lëm duke ofruar njohuri solide, të veçanta dhe sistematike mbi institutet dhe konceptet e të drejtës penale në R. e Maqedonisë dhe njohuri krahasuese nga rajoni dhe BE-ja.

Karriera

Diploma e Fakultetit juridik njihet nga Oda e avokatëve dhe noterëve në RM. Titujt profesionalë të avokatëve dhe të noterëve kërkojnë regjistrim formal në këto oda. Diploma e Fakultetit juridik u mundëson studentëve një qasje në organet shtetërore, sidomos në organet gjyqësore, si: gjykatat dhe prokuroritë publike. Fakulteti juridik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë për trajnimin e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë në RM. Studentëve që do të kenë ambicie të merren me punë hulumtuese shkencore, Fakulteti juridik i UJEL-së, u mundëson vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë (studime të doktoraturës).

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të avancuara teorike, empirike dhe krahasimtare për shkencat penale juridike si dhe njohuri të avancuara për legjdhënien dhe praktikën gjyqësore në sferën e parandalimit të kriminalitetit.
- Ka kuptim të jashtëzakonshëm për problemet që lidhen me krimin dhe sanksionet penale, veçanërisht në fushat e të drejtës krahasimtare penale dhe të së drejtës procedurale penale, kriminologjisë dhe penologjisë teorike dhe zbatimore, krimin të organizuar dhe shkencave forenzike (mjekësia, psikiatria dhe psikologjia gjyqësore).
- Ka njohuri specifike për teknikat dhe metodat e avancuara të hulumtimit në sferën e të drejtës penale dhe të procedurës penale.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Identifikon dhe analizon problemet komplekse në fushën e të drejtës dhe procedurës penale, kështu që mund të marrë

pjesë aktive në të gjitha shkallët e procedurës penale si dhe interpreton çështje të avancuara të ligdhënies penale (duke përfshirë këtu edhe punën si gjyqtar, prokuror ose avokat, pas fitimit të kualifikimeve të nevojshme sipas ligdhënies së RM-së).

- Përdor njohuritë e fituara përmes punës kërkimore në procesin e zgjidhjes së problemeve me anë të krahasimit të praktikave dhe zgjidhjeve në sferën e parandalimit të kriminalitetit.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ka mendim më të zhvilluar kritik përmes metodës së analizës dhe të krahasimit.

- Zhvillon shkathësi për zgjidhjen e problemeve përmes praktikës së zgjidhjes së rasteve më komplekse nga jurisdiksioni dhe praktika gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare.

Aftësitë e komunikimit

- Përdor terminologji adekuate për çështje komplekse dhe specifike në sferën e shkencave juridike-penale.

- Sjell vendime të avancuara dhe punon në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe efektive si në fazën parapenale dhe në procedurën gjyqësore.

- Angazhohet aktivisht në argumentimin dhe debatin shkencor.

- I përdor gjuhët zyrtare të universitetit si dhe ka shkathësi të avancuara të teknologjive të informimit në punën shkencore.

Aftësitë e të mësuarit

- Zhvillon rregullore për punë kërkimore që përdoret në profesionin e tij.

- Zhvillon një praktikë të mësimit të vazhdueshëm duke u angazhuar në trajnimin e personave që punojnë në institucionet shtetërore për parandalimin e kriminalitetit.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [MCCR1220] [6.0 SETK] **E drejta penale materiale**
- [MCCR1040] [6.0 SETK] **Kriminologjia**
- [MCCR2030] [6.0 SETK] **E drejta penale ndërkombëtare**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [MCCR1310] [6.0 SETK] **E drejta procedurale penale**
- [MCCR1420] [6.0 SETK] **Delikuenca e të miturve**
- [MCCR2010] [6.0 SETK] **Penologjia**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 3

- [MCCR1120] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [MCCR3040] [6.0 SETK] **E drejta penale e krahasuar**
- [MCCR3010] [6.0 SETK] **Viktimologjia**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

- [MCCR4010] [30.0 SETK] **Punimi i magistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **E drejta penale materiale**

Bazë për mësimdhënie në këtë lëndë janë programet e lëndëve e drejta penale - pjesa e përgjithshme dhe e drejta penale - pjesa e posaçme. Me rastin e zhvillimit të mësimin në këtë lëndë, në vend të metodës tradicionale eks katedra, aktivisht do të zbatohet metoda e studimit të rastit si dhe metoda klinike.

- **Kriminologjia**

Përvetësimi i njohurive të avancuara mbi lëndën e studimit të kriminologjisë dhe të institucioneve kryesore kriminologjike, çështjet dhe tendencat bashkëkohore si dhe të bëhen studime mbi ndikimin e faktorëve të ndryshëm në kryerjen e veprave penale, ekzaminimet kriminologjike lidhur me kryesin dhe viktimën e veprës penale si dhe identifikimi dhe analizimi çështjeve bashkëkohore kriminologjike.

- **E drejta penale ndërkombëtare**

Pas përfundimit me sukses të kursit, nga studentët pritet të kenë fituar njohuri solide mbi nocionet dhe lëndën e kësaj disipline, normat në DPN, mbi pushtetin represiv dhe jurisdikcionin e shteteve, mbi ekstradimin, azilin, transferimin e procedurës penale, bashkëpunimin dhe ndihmën penale juridike, korpusin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe jurisdikcionin të instancave ndërkombëtare penale.

- **E drejta procedurale penale**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri solide teorike dhe praktike për dispozitat procedurale penale dhe për institutet me të cilat është e rregulluar ligjërisht veprimtaria e autoriteteve procedurale dhe e pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale, si dhe të aftësohen për zbatimin praktik të tyre.

- **Delikuenca e të miturve**

Delikuentët e mitur janë në lidhje të ngushtë edhe me fenomenet e tjera socio-patologjike, siç janë: narkomania, alkoolizmi dhe prostitucioni, dukuri që sot përhapen pothuajse në çdo vend në botë, dhe, për fat të keq, ato janë të pranishme edhe në vendin tonë. Prandaj, qëllimi themelor i kësaj disipline është të zbulohen dhe të evidentohen format e reja të kësaj dukurie kriminale dhe të shpjegohen shkaqet për praninë e tyre në mënyrë që të propozohen masat e duhura për parandalim dhe represion.

- **Penologjia**

Përvetësimi i njohurisë për lëndën e studimit të penologjisë dhe të institucioneve kryesore penologjike, probleme dhe tendenca si dhe studimi i ndikimit të faktorëve të ndryshëm në ekzekutimin e sanksioneve penale, ekzaminimet penologjike lidhur me dënimet e shqiptuara për veprat penale, si identifikimi dhe analizimi i çështjeve bashkëkohore penologjike.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Studentët do të jenë në gjendje: - T'i aplikojnë metodat kryesore juridike dhe metodat tjera hulumtuese. - Të mbledhin në mënyrë kritike dhe krijuese material kërkimorë, që është relevant dhe që citohet nga autorët në mënyrë selective në përgjigjet e tyre. - Ta kuptojnë vëllimin e procesit të hulumtimit dhe qasjen në metoda të ndryshme të kërkimit shkencor dhe të jenë në gjendje ato t'i kritikojnë. - Ta studiojnë përmes qasjes së avancuar raportin midis teorisë juridike dhe praktikës kërkimore. - T'i aplikojnë shkathtësitë dhe njohuritë e mësuara në tezat e tyre.

- **E drejta penale e krahasuar**

Lënda i shqyrton sistemet penale të vendeve të ndryshme, përmes analizës sistematike të zgjidhjeve të ligjeve penale në kontekstin e kushteve dhe faktorëve ekzistues socialë, të tendencave zhvillimore, nivelizimit të legjislacionit penal si dhe harmonizimin e tij me të drejtën penale në suaza të BE-së.

- **Viktimologjia**

Problematika e viktimës, procesi i viktimizimit, rritja e numrit të njerëzve që janë të rrezikuar nga viktimizimi, kompensimi demit dhe prevenca e viktimitetit janë temat kyçe të kësaj lënde, për shkak se viktimizimi dhe mbrojtja e viktimave paraqesin një preokupim të madh të shoqërisë moderne.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve t'i bartin shkathësitë dhe dituritë e tyre për hulumtimin dhe hartimin e e detyrës më të komplikuar – shkrimit të punimit të magjistraturës. Lënda është paraparë që tërësisht të jetë praktik dhe studentët t'i fitojnë dituritë dhe aftësitë, shkathësitë dhe besimin e nevojshëm që t'i qasen hulumtimit dhe shkrimit të tezës. Lënda ka vetëm një rezultat kthyes – t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë tezën e magjistraturës me vështirësi

minimale dhe me efektivitet maksimal. Gjithçka që është paraparë që të bëhet ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe të stilit të shkrimit të tezës së magistraturës duke pasur kujdes me këtë rast për ndalimin e shërbimit me mjetet e palejueshme siç janë: plagjiatura dhe shkelja e të drejtave të autorit, që ndalohen me Statutin e UEJL-së.

Lëndë zgjedhore

- **Kriminalitsika**

Specializimi në këtë fushë është i nevojshëm sidomos për ato kuadro që do të punojnë në organet e drejtësisë – në gjykata, prokurori publike dhe në policinë gjyqësore. Kriminalistika në thelbin e saj e ka legjislacionin penal material dhe procedural, si dhe aktet nënligjore që burojnë prej zbatimit të tyre. Çdo qenie ligjore e veprës penale pëmban në vete përcaktimin e tërësisë së fakteve dhe të rrethanave që janë relevante për zgjidhjen e gjithanshme dhe të drejtë të rastit penal.

- **Psikologjia gjyqësore**

Kjo disiplinë ka karakter ndihmës për shkencat e tjera juridike penale me qëllim të vlerësimit psikologjik të së vërtetës dhe të gënjeshtres në procesin gjyqësor penal ndaj të pandehurve, dëshmitarëve dhe personave të tjerë në procedurën penale gjyqësore përmes vlerësimit psikologjik të deklaratave dhe veprimeve të tyre.

- **E drejta e kundërvajtjeve**

Qëllimi i lëndës konsiston në fitimin e njohurive të avancuara për të drejtën e kundërvajtjeve si disiplinë shkencore, si dhe për pjesën materiale dhe procedurale të saj, përfshirë këtu edhe regullimin ligjor të kundërvajtjeve sipas Ligjit për kundërvajtje.

- **Krimi i organizuar**

Krimi i organizuar, si një disiplinë e re shqyrton format, shkaqet dhe masat për parandalimin dhe eliminimin e krimit të të gjitha llojeve dhe sferave. Rëndësi e veçantë u jepet teorive të krimit të organizuar, organizatave kriminale dhe formave të manifestimit.

- **Kriminaliteti kompjuterik**

Studentët do të fitojnë njohuri të avancuara mbi llojet më të reja të veprave penale që kryhen përmes kompjutorëve dhe rrjeteve të internetit si dhe me mënyrat bashkëkohore të parandalimit të krimit të tillë, që po zhvillhet gjithnjë e më shumë në shoqëritë e sotme digjitale. Do të analizohen krime të tilla si: mashtrimet kompjuterike, falsifikimet e suftuerit kompjuterik, si format e tjera të abuzimit të internetit për qëllime kriminale etj. Do të analizohet legjislacioni vendor i posareformuar dhe ndërkombëtar dhe do të fitohen njohuri mbi standardet dhe rrjedhat botërore në këtë lëmi.

- **Mjekësia ligjore**

Aftësimi i studentëve me njohuri të avancuara për shkencën forenzike ndaj veprave penale kundër jetës dhe shëndetit të njerëzve, si dhe me terminologjinë themelore që paraqet udhëzimin kyç për koordinimin dhe komunikimin ndërmjet departamenteve hetimore dhe gjyqësore. Nëpërmjet këtij moduli studenti do të jetë në gjendje të formulojë kërkesa, urdhresat dhe parashtrësat të tjera midis gjykatës dhe ekspertëve të mjekësisë ligjore për lëshimin e urdhërave për lëndim trupor, për ekspertime mjeko-ligjore, urdhra për identifikimin e personave të gjallë, të kufomave dhe mbetjeve skeletore.

- **Dhuna në familje**

Përmes kësaj lënde, studenti do të ketë mundësi të njihet më tepër me llojet dhe kategoritë e dhunës në familje dhe si inkriminohet kjo në legjislacionin vendor dhe në konventat ndërkombëtare dhe çfarë ndihme është paraparë për viktimat e dhunës së këtillë.

- **Trafikimi me njerëz**

Trafikimi me njerëz është një formë e veçantë e krimit të organizuar dhe karakterizohet si skllavëri e ditëve të sotme. Ky tip serioz i krimit paraqet një shkëlqje të rëndë të të drejtave dhe lirive më thelbësore të njeriut, prandaj është i ndaluar dhe ndiqet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, me ligjet kombëtare dhe me mekanizmat e represionit. Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me aspektet teorike e praktike të avancuara të këtij fenomeni, duke analizuar konventat më të rëndësishme ndërkombëtare, ligjet dhe mekanizmat vendore në këtë fushë, si dhe me të kuptuarit e praktikës vendore gjyqësore që kanë të bëjnë me rastet e trafikimit me njerëz.

- **Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm**

Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm është pjesë e strategjive të institucioneve shtetërore të dizajnuara për të parandaluar dhe ndëshkuar veprime të dhunshme që lidhen me qëllimet ideologjike, politike apo aktiviste. Kjo lëndë thëllon analizën e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, format e paraqitjes së saj, faktorët që nxisin individët më afër së bashku me strukturat që përdorin dhunën në veprimet e tyre, si dhe një sërë faktorësh që i tërheqin këta individë në organizata të tilla. Lënda analizon aspektin penal-ligjor të inkriminimit të pjesëmarrjes në forcat e armatosura të huaja dhe i kushton vëmendje të veçantë mënyrës në të cilën institucionet shtetërore merren me personat që marrin pjesë në organizata të tilla, si dhe masat e ndërmarra me qëllim të de-radikalizimit të tyre.

- **Klinika juridike - e drejta penale**

Kjo lëndë paraqet program një semestral, program për për formim të njohurive të fituara nga lëndët juridiko penale. Në këtë lëndë studentët do ti aplikojnë njohuritë e fituara më herët nga lëndë konkrete penale, të cilat do ti punojnë nën mentorim të profesorit të lëndës si dhe nën mbikqyrje të një Prokurori apo avokati, me të cilët bashkërisht do të punojnë në raste konkrete më të lehta dhe do të ndihmojnë në pregaditjen e shkresave dhe ndërmarrjen e veprimeve pregaditore procedurale. Më pas, do të përsërisin materialin juridik dhe poashtu do të analizojnë burime nga vende të tjera të cilat punojnë me klinika juridike.

- **Aftësitë e të folurit gjyqësor**

Aftësitë e të folurit gjyqësor po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për zbatimin e natyrës së legjislacionit penal-juridik të R.M. Ligji i ri për procedurë penale i vitit 2010 prezanton hibrid të procedurës penale me karakter akuzator me të cilin plotësisht ndryshon rolin e palëve dhe gjykatës në procedurë. Për këtë arsye, studentët që ndjekin studime pasuniversitare në të drejtën penale, detyrimisht duhet të fitojnë edhe aftësi që lidhen me prezantimin e tyre verbal para gjykatës dhe argumentim në lidhje me raste të veçantë penal.

- **Përgatitja e provimit të jurisprudencës**

Ky program ka për qëllim të pajisë studentët e ciklit të dytë - juristëve të diplomuar për të fituar aftësi profesionale për zbatimin e pavarur të rregullave në praktikë dhe kryerjes së çështjeve juridike, dhe do të iu ndihmojë studentëve për përgaditje më të lehtë dhe më të suksesshme të Provimit të jurisprudencës. Përmes kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike të programit për provimin e jurisprudencës, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zbatimit të duhur të sistemit të mësimi praktik. Në pjesën praktike, e cila paraqet pjesë komplekse të provimit, studentët do të jenë në gjendje për të zgjidhur rastet e të drejtës civile dhe penale me përkthyes sidomos në mesin e gjyqtarëve, prokurorëve publik, përmbaruesit, avokatët, noterët, ndërmjetësuesit, etj. Pritet një lloj forme e bashkëpunimit ndërmjet studentëve dhe aktorëve të pjesës praktike për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja, si dhe mbështetjen e tyre të mëtejshme në përgatitjen e provimit të jurisprudencës.

- **Lufta kundër korrupsionit**

Qëllimi i lëndës është arritja e njohurive për definicionin e korrupsionit, format e paraqitjes dhe format e korrupsionit, karakteristikat e tij krimnologjike, si dhe aspektet juridiko penale të këtij kriminaliteti në raport me cilësitë e kryerësve dhe lartësinë e dobisë pasurore të fitur në mënyrë të kundërligjshme. Poashtu studentët do të fitojnë njohuri për instrumentat ndërkombëtare dhe Konventat për luftimin e korrupsionit si dhe për parandalimin e këtij lloji të kriminalitetit.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimim e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari i përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënie e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimim e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi

shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxënit si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorisë dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikën, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikën e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes të tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.